



Republika Kosovo-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo  
Opština štrpcë  
Komuna e Shterpçës  
Municipality of Strpce

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2 pika d.) nenin 40.2 pika b.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 12 pika 2 e Ligjit Nr.08/L-066 Mbi Ndaret Buxhetore per Buxhetin e Republikës se Kosovës Per Vitin 2022, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shterpçës 01-Nr 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shterpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 24.06.2022 miratoi këtë:

#### VENDIM

1. Me ane te ketij vendimi harmonizohen apo pershtaten programet lidhur me stafin e Organizates Buxhetore Komuna e Shterpçes, numrit të punësuarve dhe ndarjet buxhetore nëpër nën programe në tabelat 4.1. te Ligjit Nr.08/L-066 Mbi Ndaret Buxhetore per Buxhetin e Republikës se Kosovës Per Vitin 2022 dhe ate siq vijon:
  - a) Nga program buxhetor Arsimi dhe shkenca( 920) nenprogrami arsimi filllore, I mesem I ulet (93900) transferohen 3 pozita ne programi zyra e kryetarit (160) nenprogrami zyra e kryetarit (16031)
  - b) Nga program buxhetor Arsimi dhe shkenca( 920) nenprogrami arsimi filllore, I mesem I ulet (93900) transferohen 1 pozita ne program Administrata dhe Personeli (163) nenprogrami Administrata (16331)
  - c) Nga program buxhetor Arsimi dhe shkenca( 920) nenprogrami arsimi filllore, I mesem I ulet (93900) transferohen 1 pozita ne program Planifikimi Urban dhe (660) nenprogrami MjedisPlanifikimi mjedisor dhe inspeksioni (66660)
2. Pozitat e percaktuara ne pikën 1 te ketij vendi te barten vetem si pozita pa buxhet ngase per te gjitha keto pozita ka buxhet te mjaftueshem ne programet dhe nenprogramet e propozuara.
3. Kerkojm nga Ministri qe ne baze te ketij vendi te njerr vendim per pershtatjen dhe azhurimin e numrit të punësuarve dhe ndarjet buxhetore nëpër nën programe në

**tabelat 3.1.A. dhe 4.1. te Ligjit Nr.08/L-066 Mbi Ndarjet Buxhetore per Buxhetin e Republikes se Kosoves Per Vitin 2022 siq eshte percaktuar me nenin 12 pika 2 e ketij ligji dhe piken 1 te ketij vendimi.**

- 4. Ky vendim hyn ne fuqi pas miratimit nga Ministri per Financa, Buxhet dhe Transfere.**

#### **Arsyetim**

**Organizata Buxhetore Komuna e Shterpces ne vazhdimesi ka pasur probleme lidhur me pershtatjen e stafit ne programe perkatese andaj pas analizimit te gjith programeve dhe nenprogrameve eshte bere e nevojshme dhe e domosdoshme rishikimi i programe ne menyre qe komuna te fuksionoj ne menyre te rregullt dhe efikase me qellim te ofrimit te sherbimeve per qytetaret e komunes se Shterpces.**

**Ne propozimin e pikes 1 a) eshte parapare qe te plotesohet pozita per Nenkryetar te komuniteteve, Perfaquesuesit juridik te komunes, juriztit ne zyren e prokurimit, te cilat pozita jane mese te domosdoshme per funksionim normal te institucionit te komunes se Shterpces.**

**Ne propozimin e pikes 1 b) eshte parapare hapja e nje pozite per nepunes te menagjimit te parkut te vetyrave zyrtare te komunes se Shterpces. Kjo pozite eshte shum e rendesishme per menagjim me efikas dhe vendosjen e rendit dhe rregullit mbi menyren e menagjimit, kontrollit, servisimit dhe mimbajtjen e veturave zyrtare konform Rregullores per perdorimin e automjeteve zyrtare, pozit te cilen e kane te gjitha institucionet e kosoves.**

**Ne propozimin e pikes 1 c) eshte parapare qe te plotesohet pozita per zyrtarin per mbrojtje te ambientit e cila pozit eshte mese e domosdoshme ngase komuna e shterpces nuk ka asnje zyrtar i cili do te ishte ne funksion te mbykqyrjes kontrollit mbrojtjen e mjedisit dhe te ambientit te cilat obligime dalin nga ligjet ne fuqi.**

**Komuna e Shterpces ka marre per baze faktin e parapare me nenin 12 pika 1 te Ligjit Nr.08/L-066 Mbi Ndarjet Buxhetore per Buxhetin e Republikes se Kosoves Per Vitin 2022 ku eshte percakton se numri i te punesuarve ne organizate buxhetore (Komune), percaktohet ne total dhe per secilin program dhe se ne nuk do te tejkalojme numrin totale te tepunesuarve te percaktuar me ligjin ne fjale.**

**Andaj duke marre per baze faktin se neni 12 paragrafi 2 eshte parapare hapsire te pershatjes, nese ndryshimet behen brenda programeve te se njejtes organizate , me kusht qe numri total te mos ndryshoje si kufi, me qellim te funksionalizimit te Organizates Buxhetore te komunes se Shterpces, Kuvendi I komunes inicon kto ndryshime te domesdoshme me shpresen se edhe Ministri per Financa, Buxhet dhe Transfere do na ndihmoj per te dal nga kjo situat me qellimin e vetem te perbashket per te funksionuar sa me mire dhe me efikasitet me te larte.**

**Nga analiza e ligjit te buxhetit, numrit aktual te nepunesve, rezulton qe Komuna ka kete pozita te lira ne Arsim dhe shendetesi me qka do tem und te zgjedheshin problemet e stafit**

te komunes se Shterpces pa tejkaluar numrin total te lejuar me ligjin e buxhetit, i cili  
veprim do te kthente komunen ne gjendje per te funksionuar normalisht.  
Andaj:

Duke marre per baze faktet e percaktuara me larte kerkojm nga Ministri per Financa,  
Buxhet dhe Transfere qe te shqyrtoj kete vendim dhe te vendos pozitivisht.

Me respekt

